

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6982
E martë, 29 gusht 2023
Çmimi 0.40

Macroni u bën thirrje Kosovës dhe Serbisë të sillen me përgjegjësi



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBAHET FORUMI STRATEGJIK I BLEDIT ME TEMËN "SOLIDARITETI PËR SIGURINË GLOBALE"

PROPOZOHET QË DERI MË 2030 BE-JA DHE SHJETET KANDIDATE TË JENË GATI PËR ZGJERIM

FAQE 4-5



#BSF2023

BSF

Bled Strategic Forum

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, bëri thirrje që viti 2030 të caktohet si afati deri kur Bashkimi Evropian dhe vendet candidate të jenë të gatshëm për zgjerim. Ai u bëri thirrje shteteve të rajonit

të Ballkanit Perëndimor që të zgjidhin konfliktet e tyre dypalëshe. Presidenti i Këshillit Evropian, duke përsëritur se duhet evituar që konfliktet mes vendeve të ndryshme të bartën në BE, e

të cilat më pas mund të përdoren në të ardhmen për të bllokuar proceset e shteteve fqinje, kërkoi që edhe në traktatet e anëtarësimit të përfshihet "klauzola e besimit"

SBASHK-u: VITI SHKOLLOR DO TË NIS ME VËSHTIRËSI, SHKAK EKSPERIMENTI I GABUAR I MASHTI-T ME TEKSTET SHKOLLORE



KËRKOHET QË VENDIMET PËR MBYLLJEN E RRUGËVE NË PRISHTINË TË SHOQËROHEN ME KONSULTIME PUBLIKE DHE ARSYETIM LIGJOR



FAQE 6

SHPËRTHEJNË PROTESTAT NË LIBI, PAS KONTAKTEVE TË MINISTRES ME IZRAELIN F. 2

FILLOI ADOPTIMI I QENVE ENDACAKË NË PRISHTINË F. 7

PËRDORUES TË KOKAINËS, MOSHA GJITHNJË E MË TË REJA F. 6

EKONOMI



PARATË E DIASPORËS, "INFUZION" PËR EKONOMINË F. 8

ASETET E FONDEVE PENSIONALE KAPIN VLERËN E 2.6 MILIARDË EUROVE F. 8

SPORT



ILIR BLAKÇORI, 'YLLI I JAVËS' NË SUPERLIGË F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Shpërthejnë protestat në Libi, pas kontakteve të ministres me Izraelin

TRIPOLI, 28 GUSHT - Qeveria e Libisë njoftoi të dielën se e ka pezulluar ministren e Punëve të Jashtme, Najla al-Mangoush, për shkak se homologu i saj izraelit tha se kishte mbajtur takim me të javën e kaluar në Romë.

Libia nuk e njeh Izraelin, pasi Tripoli e përkrah kauzën palestineze, dhe ky takim ka nxitur protesta të mëdha.

Najla al-Mangoush është "pezulluar përkohësisht" dhe do të jetë subjekt i një "hetimi administrativ" nga një komision i udhëhequr nga ministri i Drejtësisë, tha më 27 gusht kryeministri i Libisë, Abdulhamid Dbeibah.

Ministria e Jashtme e Libisë e përshkroi atë si "një takim i rastësishëm dhe jozyrtar", por lajmet rreth këtij takimi kanë nxitur tashmë protesta nëpër rrugët e qyteteve të Libisë.

Gjithçka nisi të dielën kur Ministria e Jashtme e Izraelit tha se ministrat e Jashtëm të të dyja vendeve ishin takuar në



Romë javën paraprake.

Ajo tha se ministri i Jashtëm izraelit, Eli Cohen, dhe Mangoush, homologa e tij libiane, biseduan gjatë një takimi në Romë, nikoqir i të cilit ishte ministri i Jashtëm i Italisë, Antonio Tajani.

Izraeli e përshkroi atë si nisma e parë e tillë diplomatike mes dy vendeve. "Bisedova me

ministren e Jashtme për mundësitë e mëdha që këto dy vende i kanë nga lidhjet e tyre", tha Cohen në një komunikatë për media.

Por, Ministria e Jashtme e Libisë tha të dielën mbrëma se Mangoush kishte "refuzuar të takohet me çfarëdo pale" që e përfaqëson Izraelin. "Çfarë ndodhi në Romë ishte takim i

rastësishëm dhe jozyrtar, gjatë një takimi me homologun italian, në të cilën nuk pati asnjë bisedë, marrëveshje apo konsultim", tha Ministria e Jashtme e Libisë.

Ministrja e përsëriti "në mënyrë të qartë qëndrimin e Libisë karshi kauzës palestineze", sipas saj.

Ministria libiane e akuzoi

Izraelin se po përpiqet "ta paraqesë këtë incident" si një "takim apo bisedime".

Në komunikatën e Ministrisë së Jashtme të Izraelit, Cohen citohet të ketë thënë se ata biseduan për "rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë së hebrenjve të Libisë, e cila përfshin rinovimin e sinagogës dhe varrezave hebraike në Libi".

Takimi mes tyre në Romë nuk është konfirmuar deri tani.

Sikur shumë vende të Afrikës Veriore, edhe Libia ka një histori të pasur hebraike.

Por, gjatë sundimit dekadash të ish-liderit Muamar Gadafi, i cili ishte mbështetës i fuqishëm i kauzës palestineze, mijëra hebrenj u dëbuan nga Libia dhe shumë sinagoge u shkatërruan.

Gadafi u rrëzua nga pushteti dhe u vra gjatë një trazire të përkrahur nga NATO-ja më 2011, e cila e zhyti vendin në një rrëmujë dhe mungesë ligji për më shumë se një dekadë.

Qeveria franceze e sheh veshjen islamike në shkolla si "sulm politik"

PARIS, 28 GUSHT - Veshja e fustaneve abaja nga disa vajza myslimane në shkollat franceze është "sulm politik", tha të hënën zëdhënësi i Qeverisë së Francës, Olivier Veran, derisa e shpjegoi ndalimin e kësaj veshjeje.

Ministri i Arsimit i Francës, Gabriel Attal, tha të dielën se fustanet e gjata e lirshme, me origjinë nga Lindja e Mesme, nuk do të lejohen më në shkolla nga viti i ri shkollor që nis javën e ardhshme, sepse e shkelin ligjin laik.

Abaja është një fustan që mbulon tërë trupin, përveç kokës, dhe kombinohet me një hijab apo mbulesë tjetër e kokës nga gratë myslimane në vende e botës myslimane, kryesisht në Lindjen e Mesme. Veran tha se abaja "është qartazi" veshje fetare dhe



"sulm politik, shenjë politike", të cilën ai e cilëson si përpjekje për konvertim në islam. "Shkolla është laike. Ne e themi këtë në mënyrë shumë të qartë por të prerë: nuk është vend për atë [veshjen e rrobave fetare]", theksoi Veran për televizionin

BFM. Attal tha të hënën se Qeveria e ka bërë të qartë se abaja "nuk e ka vendim në shkolla". "Shkollat tona po sprovohen. Muajt e fundit, shkëlja e rregullave laike është rritur dukshëm, posaçërisht për veshjen e rrogave fetare, siç

është abaja apo qamisi, të cilat janë parë dhe kanë mbetur në disa institucione", tha Attal.

Vendimi i Attalit për ta ndaluar abajasin ka nxitur debat të ri për rregullat laike të Francës, dhe nëse ato po përdoren për ta diskriminuar pakicën e madhe myslimane të vendit.

Një ligj në mars të vitit 2004 e ndaloi "veshjen e shenjave apo rrogave në shkollë përmes të cilave studentët tregojnë se i përkasin një feje". Kjo përfshin kryqë të mëdha të fesë krishtere, kapela hebraike (kippas) dhe shami islamike. Qeveria ua ka mbajtur anën politikanëve djathtistë dhe të ekstremit të djathtë, të cilët kanë bërë trysni për ndalimin e kësaj veshjeje menjëherë, duke argumentuar se ajo është pjesë

e një agjende më të gjerë nga islamistët për ta përhapur praktikimin e fesë nëpër shoqëri.

Por, politikanët majtistë dhe shumë myslimanë i cilësojnë rregullat laike të Francës si një front i përdorur nga konservatorët për politika islamofobike.

Kushtetuta e Francës ua garanton qytetarëve të drejtën për ta praktikuar fenë lirshëm, por i detyron shtetin dhe punonjësit e shtetit ta respektojnë neutralitetin.

Ndaj ndalesës së abajasit pritet të ketë ankesë ligjore dhe kjo do t'ua vështirësojë punët autoriteteve shkollore të cilat do të duhet të vendosin se kur një fustan i gjatë i lirshëm kalon nga një zgjedhje personale mode në një qëndrim fetar, thonë mbikëqyrësit.

Irani thotë se Iraku është pajtuar për çarmatimin e militantëve kurdë

TEHRAN, 28 GUSHT - Irani dhe Iraku kanë arritur marrëveshje për çarmatimin dhe zhvendosjen e "grupeve të armatosura terroriste" të rajonit kurd të Irakut, njoftoi të hënën Ministria e Jashtme e Iranit. "Është arritur një marrëveshje mes Iranit dhe Irakut, sipas të

cilës Iraku është përkushtuar t'i çarmatosë separatistët e armatosur dhe grupet terroriste në territorin e vet, t'i mbyllë bazat e tyre, dhe t'i zhvendosë ata në vende të tjera para 19 shtatorit", tha zëdhënësi i Ministrisë iraniane, Nasser Kanaani.

Kanaani nuk tregoi se ku do të zhvendoseshin militantët. Iraku nuk ka komentuar ende rreth kësaj.

Irani ka kohë të gjatë që e akuzon rajonin autonom kurd të Irakut verior se po rrit grupe terroriste, të cilat janë përfshirë në sulme kundër Republikës Islamike.



SBASHK-u: Viti shkollor do të nis me vështirësi, shkak eksperimenti i gabuar i MASHTI-t me tekstet shkollore



EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 GUSHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (MASHTI) ka dështuar të arrijë pajtim me shtëpitë botuese për tekstet shkollore dhe ka njoftuar se transferimi i mjeteve për sigurimin e teksteve shkollore sipas obligimit ligjor të MASHTI-t të bëhet në llogaritë e prindërve dhe të njëjtët t'i blejnë tekstet për fëmijët e tyre.

Kjo ministri ka hapur platformën e-Kosova për aplikim për subvencionimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore nga ana e prindërve, ku pas aplikimit mjetet të dalin në xhironlogaritë e prindërve.

Deri më tani janë mbi 50 mijë aplikime në platformën e-Kosova vetëm disa ditë pas lansimit të programit.

Por kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBASHK), Rrahman Jasharaj këtë ide e ka quajtur eksperiment të gabuar.

Në takimin me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të

universiteteve, Jasharaj ka theksuar të hënën se fatmirësisht ky vit shkollor po fillon pa greva, por me vështirësi shkak i MASHTI-t. "Ky vit po fillon pa greva e veprime sindikale, e kjo do duhej ta gëzonte edhe qeverinë e veçmas ministren Nagavci, por duket se më shumë do t'i gëzonte greva për ta drejtuar gishtin drejt nesh e për tu heshtur lëshimet e mungesa e përgatitjeve që MASHTI do të duhej ti bënte. Ky vit shkollor do të filloj i përcjellë me vështirësi të cilat i krijoi MASHTI me eksperimentin e gabuar për tekstet shkollore", ka thënë Jasharaj.

Ai shtoi se SBASHK-u me kohë ka reaguar për këtë çështje, derisa kritikoi ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci që po mban inate me sindikatën e arsimit.

"Zonja Nagavci po e mban inatin nga grevat sepse nuk po takohet me SBASHK-un, këshillin e prindërve, DKA-të e as me Asociacionin e Komunave. Ajo doli me një lajm që i ka shqetësuar edhe prindërit dhe neve si mësimdhënës. Ajo sjell vendim që tekstet shkollore të

shpërndahen nëpër librari që një pjesë e qyteteve nuk ka fare, dhe prindërit të vrapojnë në e-Kosova të aplikojnë dhe të presin rimbursimet", ka pohuar Jasharaj.

I pari i SBASHK-ut, shtoi se viti shkollor nuk do të fillojë si duhet sepse do të kalojnë ditë e ditë e nxënësit nuk do të jenë të pajisur me mjete shkollore, jo me fajin e tyre por me faj të MASHTI-t.

Ai shtoi se Ministria e Arsimit është tekanjoze, duke thënë se hodhi poshtë vendimin e Këshillit Shtetëror të Licencimit duke thënë se asnjë trajnim nuk mund të bëhet nga ana e SBASHK-ut që kanë qenë për ngritje profesionale.

Ndërkaq, Ymer Ymeri nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, ka thënë se pret që një numër i konsiderueshëm i prindërve nuk do të mund të aplikojë për subvencionim e teksteve shkollore.

Ai ka thënë se me këtë formë nuk do të mund të kontrollohet se kujt po i jepen mjete për libra. "Presim që një numër i konsiderueshëm i prindërve nuk do të mund të regjistrohen

për të aplikuar për subvencionim të librave dhe mendoj se kjo është e gabueshme, më pas nuk do të ketë mundësi as të kontrollojmë se kujt po i jepen mjete për libra, sepse për shkak se të njëjtën mund ta bëjnë edhe disa prindër që jetojnë në Gjermani, por janë të regjistruar në Kosovë, mendoj se ka qenë një gabim dhe një neglizhencë e ministrisë që nuk janë përgatitur me kohë, por e kanë lënë të vijë gjendja në këtë situatë", ka thënë Ymeri.

MASHTI ka njoftuar se këtë vit shkollor do të sigurojë tekstet e reja për nxënësit e klasave 1-5, ndërsa për nxënësit e klasave 6-9 do të jenë në dispozicion tekstet e vitit paraprak. Për klasat 6-9, tekstet tashmë ndodhen në shkolla, dhe do t'u ndahen nxënësve sapo të fillojë mësimi.

Për secilin nga nxënësit filloristë (klasa 1-5), në total do të ndahen nga 80 euro, 50 euro për tekstet shkollore dhe 30 euro për mjetet mësimore. Ndërsa për nxënësit e arsimit në nivelin e mesëm të ulët (klasat 6-9) të cilët i kanë librat të siguruar nga viti paraprak, do të ndahen nga 30

euro për mjetet mësimore. MASHTI ka bërë me dije se do ta përcjell procesin e aplikimit me shumë vëmendje dhe do ta adresojë secilën sfidë që paraqitet, si në aspekt teknik e po ashtu edhe përmbajtësor.

MASHTI ka theksuar se në bashkëpunim me DKA-të dhe shkollat, do të sigurohen që të gjithë fëmijët të jenë të pajisur me tekste shkollore.

Partitë opozitare, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e kanë kritikuar Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe Qeverinë e Kosovës lidhur me planin e ri të shpërndarjes së teksteve shkollore për fëmijët.

Këto tri partie opozitare kanë kërkuar dorëheqjen e ministres Arbërie Nagavci shkak i asaj që e ka cilësuar si "keqmenaxhim i vitit shkollor".

Sipas opozitës Kosova nuk e meriton një ministere që ka dështuar në çdo nivel ta menaxhojë arsimin dhe përfundimisht është dorëzuar duke ua kaluar përgjegjësinë prindërve.





MBAHET FORUMI STRATEGJIK I BLEDIT ME TEMËN "SOLIDARITETI PËR SIGURINË GLOBALE"

Propozohet që deri më 2030 BE-ja dhe shtetet kandidate të jenë gati për zgjerim

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, bëri thirrje që viti 2030 të caktohet si afati deri kur Bashkimi Evropian dhe vendet kandidate të jenë të gatshëm për zgjerim. Ai u bëri thirrje shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor që të zgjidhin konfliktet e tyre dypalëshe. Presidenti i Këshillit Evropian, duke përsëritur se duhet evituar që konfliktet mes vendeve të ndryshme të bartën në BE, e të cilat më pas mund të përdoren në të ardhmen për të bllokuar proceset e shteteve fqinje, kërkoi që edhe në traktatet e anëtarësimit të përfshihet "klauzola e besimit"

BLED, 28 GUSHT- Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, bëri thirrje që viti 2030 të caktohet si afati deri kur Bashkimi Evropian dhe vendet kandidate të jenë të gatshëm për zgjerim.

Gjatë fjalimit në Forumin Strategjik të Bledit, ai përsëriti disa herë se tash e tutje vendeve kandidate duhet referuar si "vende të ardhshme anëtare të BE-së".

Michel tha se BE-ja duhet të përballet me dilemën se a do të jetë vetëm një union që merret me menaxhimin e krizave apo

një aktore që vendos për të ardhmen.

Ai pranoi se rruga e gjatë e shteteve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së, që ka nisur para më shumë se 20 vjetësh, ka shkaktuar zhgënjim te shumë njerëz, si në rajon, ashtu edhe në bllokun evropian. "Pajtohem me kancelarin [e Gjermanisë, Olaf] Scholz kur thotë se BE-ja duhet të mbajë premtimet e veta", shtoi Michel.

Kësaj radhe, presidenti i Këshillit Evropian bëri thirrje edhe për caktimin e një

agjende të qartë e me afate kohore. "Në kohën kur ne po përgatisim agjendën e ardhshme të BE-së, duhet të vendosim para vetes edhe caqe të qarta. Unë besoj se ne duhet të jemi gati, nga të dyja anët, që më 2030 të zgjerohemi. Kjo do të thotë se buxheti i ardhshëm shumëvjeçar duhet të përfshijë edhe këto qëllime tona. Kjo është shumë ambicioze, por e domosdoshme. Dëshmon se ne jemi serioz. Do të krijojë momentum", tha ai.

Michel paralajmëroi se në samitin e ardhshëm të BE-së

liderët do të diskutojnë edhe për procesin e zgjerimit. Por, nga temat në kuadër të zgjerimit, ai përmendi vetëm mundësinë e hapjes së negociatave të anëtarësimit me Ukrainën dhe Moldavinë, si dhe kthimin e Bosnje e Hercegovinës në agjendë.

Ai e pranoi se do të ishte ideale që të gjithë të hynin në BE në të njëjtën kohë, por theksoi se procesi i zgjerimit do të vazhdojë të mbesë i bazuar në meritat e vende që janë në proces. Në këtë kontekst ai përmendi edhe përshtatje e vendeve aspiruese me politikën e BE-së, përfshirë edhe në fushën e politikës së jashtme dhe të sigurisë.

Michel u bëri thirrje shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor që të zgjidhin konfliktet e tyre dypalëshe. "Zgjidhja e konflikteve dypalëshe nga e kaluara mund të jetë më e dhimbshme sesa reformat. Por, është e domosdoshme. Ju në këtë rrugë do të ndiqni rrugën e

njëjtë sikurse edhe vendet themeluese të BE-së. Nuk ka bashkëpunim pa pajtim. Dhe, të jemi shumë të qartë, nuk ka vend në BE për konfliktet e së kaluarës", theksoi ai.

Presidenti i Këshillit Evropian, duke përsëritur se duhet evituar që konfliktet mes vendeve të ndryshme të bartën në BE, e të cilat më pas mund të përdoren në të ardhmen për të bllokuar proceset e shteteve fqinje, kërkoi që edhe në traktatet e anëtarësimit të përfshihet "klauzola e besimit". Kjo, sipas tij, do të siguronte që vendet të cilat hyjnë në BE që të mos kenë mundësi të bllokojnë vendet e ardhshme anëtare.

Gjatë fjalimit në Forumin e Bledit përsëriti edhe idenë që shtetet kandidate gradualisht të përfshihen në disa politika të BE-së pa pasur nevojë që të presin anëtarësimin formal në bllok. Kjo, sipas tij, do të bëhej në ato fusha në të cilat vendi përkatës do të mbyllë kapitullin në negociatat e anëtarësimit.

Macroni u bën thirrje Kosovës dhe Serbisë të sillen me përgjegjësi



PRISHTINË, 28 GUSHT- Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka paralajmëruar të hënën se vendi i tij do t'i rishikojë zotimet që i ka bërë për çështje ekonomike dhe politika të vizave për Kosovën dhe Serbinë, nëse ato nuk sillen me përgjegjësi. Duke folur më 28 gusht në një fjalim vjetor para ambasadorëve francezë në Paris, Macron tha se nga Kosova dhe Serbia pritet angazhim i qartë në zgjidhjen e situatës në veri të Kosovës në mënyrë paqësore. "Franca dhe Gjermania i kanë bërë premtimet e tyre për politikën e vizave dhe çështjet tjera ekonomike, të cilat do të rishikohen nëse të dy palët

nuk sillen me përgjegjësi. Ne duhet të jemi tejet kujdesshëm në këtë drejtim, posaçërisht kur stabiliteti i Ballkanit Perëndimor është në rrezik", tha Macron. Ambasadorët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian u pajtuan më 30 nëntor të vitit të kaluar për t'i dhënë mandatin Këshillit Evropian që të negociojë procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën me Parlamentin Evropian. Lëvizja pa viza për kosovarët do të mundësohet nga 1 janari i vitit 2024. Komentet e Macronit vijnë në një kohë kur Kosovës i është bërë thirrje vazhdimisht të kthehet në dialog me Serbinë dhe t'i organizojë zgjedhjet e

reja në veri të vendit. Situata në veri të Kosovës u përshkallëzua në maj, kur në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok - kryetarët shqiptarë e morën pushtetin, ndërsa në ndërtesat komunale kanë hyrë me ndihmën e policisë. Ata i ka kundërshtuar ashpër popullata lokale serbe, e cila i ka bojkotuar zgjedhjet e prillit, nga të cilat kanë dalë ata kryetarë. Banorët lokalë ka gati tre muaj që protestojnë para objekteve komunale në Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok, duke kërkuar nga Policia e Kosovës që të tërhiqet dhe nga kryetarët shqiptarë që të mos

dalën në punë. Autoritetet e Kosovës kanë treguar gatishmëri për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, mirëpo ende nuk është caktuar ndonjë datë. Kosova ka shprehur gatishmëri për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në veri të vendit. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal i Kosovës, Elbert Krasniqi, tha më 21 gusht se procesi për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat në veri të Kosovës do të determinohet së shpejti. Ai nuk dha detaje lidhur me punën e bërë deri më tani nga grupi punues për hartimin e udhëzimit administrativ që mundëson nisjen e peticionit

për largimin e kryetarëve të komunave, pasi që tha se udhëzimi administrativ do të jetë gati në fund të muajit gusht. "Si ministri dhe si ministër kam mbuluar përgjegjësinë time duke filluar me udhëzimin administrativ, i cili parasheh të drejtën e qytetarëve për mbledhjen e nënshkrimeve për largimin e kryetarëve nga detyra", tha Krasniqi për media pas përfundimit të punimeve për zgjerimin e një rruge në Gjakovë të hënën. Krasniqi tha se zgjedhjet e parakohshme mund të zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune.

Në këtë drejtim ai përmendi disa fusha, sikurse atë të energjisë dhe transportit, që tha se do të ofronin mundësi që përfaqësuesit e shteteve kandidatë të merrnin pjesë në takimet përkatëse të Këshillit të BE-së. Michel paralajmëroi se gjatë dhjetorit do të thërrasë samitin e ri të përbashkët BE-Ballkani Perëndimor. Ai shprehu mirëkuptim edhe për thirrjet e disa shteteve të BE-së, veçmas të kreut të Francës, Emmanuel Macron, që edhe BE-ja të bëhet gati të pranojë shtete të reja anëtare dhe për këtë çështje të ndërtojë kapacitete absorbuese. "Pajtohem tërësisht me presidentin Macron. Mosreformimi nga ana jonë para zgjerimit të ardhshëm do të ishte një gabim i madh. Të

jemi të sinqertë, nganjëherë kemi shfrytëzuar mungesën e progresit nga vendet e ardhshme anëtare për të evituar mospërgatitjen nga ana jonë. Tani duhet seriozisht të shikojmë kapacitetet e BE-së për të absorbuar vendet tjera anëtare. Kjo ide nganjëherë është keqkuptuar si një pengesë e fshehur për zgjerim. Është e kundërta. Është e kuptueshme që për vendet anëtare ka vlerë t'i bashkohen një BE-je që është efikase", tha ai. Sipas Michel, ndër argumentet se pse BE-ja duhet të përgatitet për zgjerim në të ardhmen është se të gjitha shtetet kandidatë kanë nivel të ulët të bruto prodhimit vendor krahasuar me atë të BE-së. Prandaj, anëtarët e rij do të përfitonin nga buxheti i



përbashkët i bllokut evropian. Duke përmendur disa herë edhe agresionin e përvokuar të Rusisë në Ukrainë, Michel tha se kjo luftë në themel e ka ndryshuar situatën globale të

sigurisë dhe ka pasur ndikim të madh në të ardhmen e kontinentit. "Për të qenë më të fortë dhe më të sigurt ne duhet të forcojmë lidhjet tona dhe të bëhemi më të fuqishëm.

Prandaj, tani është koha që të merremi me sfidat e zgjerimit, si për ne në BE, ashtu edhe për shtetet tona të ardhshme anëtare. Por, besoj se ne tani duhet t'i quajmë këto shtete me perspektivë evropiane si shtete të ardhshme anëtare", tha ai. Në Forumin e Bledit në Slloveni kanë marrë pjesë liderët e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, por edhe liderët të disa shteteve të BE-së. Pjesë e këtij forumi ishte edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Forumi strategjik i Bledit mbledh çdo vit pjesëmarrës nga fusha të ndryshme, të cilët ndajnë pikëpamje dhe gjenerojnë ide për të adresuar sfidat e tanishme dhe sfidat e së ardhmes.

Përdorues të kokainës, mosha gjithnjë e më të reja

PRISHTINË, 28 GUSHT - "Kam nisur me marihuanë kur i kam pasur 13 vjet. Tash i kam 39", ka rrëfyer Agimi për "Radion Evropa e Lirë".

Tash e pesë vjet, ai ka thënë se po bën përpjekje të lirohet tërësisht nga varësia e drogës. Kur kishte nisur të merrte marihuanë, thotë se jetonte në një shtet të Evropës perëndimore. Më pas, një tragjedi familjare, kur ishte 24 vjeç, e kishte futur në rrugën e krimin dhe kishte përfunduar në burg. "Gjashtë vjet i kam mbajtur (dënim me burg). Nga mërzia nuk mund të kaloja kurrësi. Atëherë... aty erdhi një shqiptar tjetër, pak më i moshuar. Më tha: 'a do të të ndihmoj, sepse unë mund të ndihmoj që t'i harrosh të gjitha këto'. I thashë: 'si o burrë i fortë'. Atëherë, ma ka hedhur përpara (heroinën). E kam marrë. Prej asaj dite... unë në burg kam filluar me heroinë", ka thënë Agimi - identiteti i vërtetë i të cilit është i njohur për redaksinë e "REL"-it.

Pas daljes nga burgu, shteti perëndimor ku jetonte, ia ka hequr lejen e qëndrimit dhe ai u detyrua të kthehej në Kosovë. Problemet që kishte me drogën, thotë se ishin shkak i divorcit nga bashkëshortja e tij, por edhe i zënkave me familjarë të tjerë dhe i sëmundjeve të njëpasnjëshme që përjetoi, përfshirë edhe një infarkt. "Më ka shkaktuar dhimbje, sëmundje... të gjitha të këqijat. Është shumë problem, sepse është vështirë të largohesh prej saj. I kisha lutur të gjithë... rininë... bëni çfarë bëni, por vetëm këtë (drogën) mos e prekni", ka thënë Agimi.

Vite më parë, ai është drejtuar për ndihmë në Qendrën Mediko-Psikoterapeutike Labirint - një organizatë jofitimprurëse me seli në Prishtinë, e cila merret me trajtimin e personave të varur nga droga.

Në këtë qendër, ai është nënshtruar terapisë në kuadër të Programit të Metadonit. Ky është një ilaç, i cili, sipas autoriteteve kompetente, heq dëshirën për përdorimin e drogës, kryesisht të heroinës. Agimi ka thënë se dikur e merrte më shpesh atë, ndërsa tash vetëm kur i shfaqen, siç shprehet, kriza të patejkalueshme.

Shifrat e Qendrës "Labirint" tregojnë se mosha mesatare e përdoruesve të drogës në Kosovë është në trend të rënies, ndërsa numri i të varurve nga droga, të cilët kërkojnë ndihmë profesionale, është në rritje nga viti në vit.

Në databazën e kësaj qendre, aktualisht, janë të regjistruar



mbi 2 850 persona që kërkojnë ndihmë, e që vijnë nga pjesë të ndryshme të Kosovës, thotë drejtori Safet Blakaj, njëherësh defektolog.

Sipas tij, pothuajse kaq është edhe numri i atyre personave që kërkojnë herë pas here shërbime në qendër dhe nuk dëshirojnë të regjistrohen. Në mesin e vitit të kaluar, në këtë qendër kanë qenë të regjistruar 2.762 persona, ndërsa në fund të vitit 2021 kanë qenë 2.420. Të regjistruarit, sipas Blakajt, cilësohen si përdorues problematikë të drogave. Persona të tillë, thotë ai, konsiderohen "ata që bëhen jofunksionalë, kanë probleme sociale ose me familjen, si dhe janë në konflikt me ligjin".

Blakaj ka thënë se trendi i përdoruesve të heroinës është në rënie, por si mjaft shqetësues e shih trendin e përdoruesve të kokainës - të dyja substanca që hyjnë në kategorinë e drogave të rënda. "Më 2018-2019, ne kemi pasur persona të moshës 35 deri në 45 vjeç që kanë ardhur (në Qendrën Labirint). Ndërsa, vitin e kaluar, (kjo moshë mesatare) ka rënë në 25 deri në 35 vjeç, me tendencë të rënies edhe më tutje. Po flasim për përdorues të kokainës. Është përhapur me shpejtësi. Përveç nga qendrat urbane, ne kemi (përdorues) edhe nga viset rurale. Kjo na tregon se ka shtrirje të gjerë të përdorimit (të drogës në Kosovë)", ka thënë Blakaj për "Radion Evropa e Lirë".

Në Kosovë nuk ka ndonjë qendër rehabilituese afatgjate, që do të ishte nën ombrellën e institucioneve shëndetësore të shtetit. Në shumë raste, të varurit nga droga orientohen për rehabilitim afatgjatë në

qendra jashtë vendit. "REL"-i ka kontaktuar Faton Kutllovcin, drejtor i Klinikës së Psikiatrisë në Prishtinë, në të cilën gjendet reparti për sëmundjet e varësisë, por ai nuk dha informacione për numrin e përdoruesve të drogave që janë trajtuar në gjashtëmuorin e parë të këtij viti në këtë klinikë, e as për moshën e tyre mesatare.

Në një deklaratë me shkrim dhënë "Radios Evropa e Lirë", Policia e Kosovës ka thënë se brenda gjashtë muajve të parë të këtij viti, ka arrestuar 102 përdorues të drogave. Mosha mesatare e tyre sillet nga 16 deri në 35 vjeç. Tre nga këta të arrestuar, sipas Policisë së Kosovës, janë të moshës 16 vjeç. Brenda gjashtë muajve të vitit 2023, nga përdoruesit e substancave narkotike janë konfiskuar rreth 5 gramë heroinë, rreth 58 gramë kokainë dhe rreth 1 kg marihuanë, ka bërë me dije policia.

Në të njëjtën periudhë, sipas saj, nga trafikuesit e substancave narkotike në tërësi janë konfiskuar rreth 2.6 kg heroinë, 4.6 kg kokainë, rreth 303 kg marihuanë, 3.5 kg hashash, rreth 1 kg ekstazi, mbi 1.100 bimë kanabisi, 120 gramë amfetaminë dhe rreth 2 kg droga të tjera.

Ndërsa për veprat penale "blerja, posedimi, shitja dhe shpërndarja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge", si dhe për "kultivimin e bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit", policia "ka hapur 291 raste dhe ka arrestuar 387 persona". Me Kodin Penal të Kosovës është e jashtëligjshme

që qytetarët të blejnë, posedojnë apo shpërndajnë substanca narkotike; ata mund të dënohen me gjobë apo burgim, varësisht nga sasia dhe lloji i lëndës narkotike, që iu kapet nga autoritetet e rendit. Agimi ka thënë se mundësitë e përdoruesve të drogës për të siguruar substanca të ndryshme narkotike, janë të shumta. "Vështirë nuk është fare... mund të gesh gjithçka - kokainë, heroinë, marihuanë, ekstazi, çfarëdo që dëshiron", ka thënë Agimi, i cili përmend edhe lokacione specifike në Prishtinë, por të cilat "REL"-i nuk ka mundur t'i konfirmojë.

Ende pa strategji të re kundër drogave

Se sa është numri i saktë i personave që përdorin drogë në Kosovë, mbetet e paqartë. Blakaj ka thënë se vitin e kaluar, bazuar në të dhënat e mbledhura nga institucionet dhe nga terreni, ky numër ka qenë rreth 30 mijë, ndërsa këtë vit trendi është në rritje. "Ne konsiderojmë se numri i përgjithshëm shkon në rreth 40 mijë në Kosovë. Nuk jemi të sigurt se a do të vazhdojë ky trend, që është shumë me rëndësi, a do të mund ta ngadalësojmë... Për momentin, nuk kemi shumë mundësi që ta zvogëlojmë rritjen e shpejtë të tyre. Presim që sa më shpejt të nisë përgatitja e Strategjisë nacionale kundër drogave, që bashkë me institucionet dhe aktorët tjerë të merrin shumë më seriozisht kjo çështje", ka thënë Blakaj.

Deri para një viti, Strategjia nacionale e luftës kundër drogave ka qenë ajo e viteve 2018-2022.

Përgatitja e një strategjie të tillë është kompetencë e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës. Në një deklaratë me shkrim dhënë "Radios Evropa e Lirë", kjo ministri ka thënë se përgatitjet për të kanë nisur me një vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e Strategjisë shtetërore kundër narkotikëve dhe planit të veprimit. MPB-ja nuk e ka specifikuar se kur është themeluar ky ekip, por tha se "Strategjia e re pritet të përfundojë në fund të vitit 2023, duke i respektuar afatet kohore të parapara në planin e punës". "Ky dokument do të jetë i strukturuar që në mënyrë të qartë t'i identifikojë objektivat dhe aktivitetet që duhet të përmbushen, në mënyrë që i gjithë mekanizimi institucional të vihet në funksion të parandalimit dhe luftimit me sukses të narkotikëve", ka thënë MPB-ja. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, motivet që çojnë në abuzim me substanca narkotike janë disa - nga kurioziteti deri te dëshira për t'i harruar problemet. Sipas saj, strategjitë e parandalimit të abuzimeve duhet të bazohen në prova shkencore dhe t'i kenë në shënjestër familjet, shkollat dhe komunitetet, sidomos ato që janë më të marginalizuara dhe më të varfra. Nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Kosovë kanë thënë më herët për "Radion Evropa e Lirë" se, çdo vit, mbajnë aktivitete edukativo-shëndetësore për dukuritë si: varësia nga droga, duhani apo alkooli. Ato përfshijnë shpërndarjen e materialeve për edukim dhe promovim shëndetësor.

Filloi adoptimi i qenve endacakë në Prishtinë

PRISHTINË, 28 GUSHT- Ka filluar adoptimi i qenve endacakë në Prishtinë. Kryetari i kryeqytetit Përparim Rama ka thënë se tashmë secili qen në kryeqytet do të ketë një pronar. "Jemi siguruar që të ofrojmë kushte dhe trajtim human për qentë dhe siguri

shtesë për qytetarët e kryeqytetit. Jam shumë falënderues që një numër i madh i qytetarëve kanë shprehur interesim për adoptim. Ju lus që të kenë kujdes për këto krijesa dhe të tregoni dashuri ndaj tyre. Secili nga qentë që jepet për adoptim do të jetë i pajisur

me mikroçip dhe numri i tij është i vendosur edhe në kontratë, monitorimi i të cilit do të bëhet nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë", ka thënë Rama.

Komuna e Prishtinës do të ndajë nga 50 euro në muaj për qytetarët që adoptojnë qen endacak.



Kërkohet që vendimet për mbylljen e rrugëve në Prishtinë të shoqërohen me konsultime publike dhe arsyetim ligjor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 GUSHT - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka reaguar ndaj vendimit të kryetarit të Komunës së Prishtinës për mbylljen e qarkullimit të mjeteve motorike në një pjesë të rrugëve "Rexhep Luci" dhe "Qamil Hoxha" si dhe në rrugët e rrugicat të cilat kalojnë nëpër parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare. Ky vendim është nxjerrë më 18 gusht 2023 dhe është publikuar më 21 gusht 2023, derisa i njëjti pritet të hyjë në fuqi më 1 shtator 2023.

Fillimisht, IKD-ja ka theksuar se e ka parasysh rëndësinë e ndërmarrjes së reformave për rregullimin urban të kryeqytetit. "Këto çështje hyjnë në kuadër të diskrecionit të Komunës së Prishtinës dhe këtë duhet ta bëjë me ekspertët e fushës. Mirëpo, këto reforma nuk duhet të jenë pa arsyetim ligjor në atë mënyrë që të cenojnë të drejtat e qytetarëve. Për më tepër, vendime të kësaj natyre që prekin një numër të madh të qytetarëve domosdoshmërisht duhet të shoqërohen me konsultim publik. Vendimi i datës 18 gusht 2023 për mbylljen e qarkullimit të mjeteve motorike në një pjesë të rrugëve 'Rexhep Luci' dhe 'Qamil Hoxha' si dhe në rrugët e rrugicat të cilat kalojnë nëpër parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare është marrë në shkelje të dispozitave lidhur me procedurën administrative dhe dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të



aktit administrativ, duke e bërë kështu këtë vendim të paligjshëm, në kuptim të nenit 52 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje: LPPA). Ky vendim nuk është hartuar në përputhje me paragrafin 1 të nenit 47 të LPPA, ku shprehimisht thuhet se akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, [...], 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), [...] 1.3. pjesën arsyetuese (arsyetimin), [...] 1.4. pjesën përmblylëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin

përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike)", theksohet në reagimin e KDI-së.

Si rrjedhojë, KDI-ja ka theksuar se është e qartë se vendimi në fjalë është hartuar tërësisht në kundërshtim me LPPA, meqë i njëjti, nuk përmban as arsyetimin dhe as këshillën juridike.

Sipas KDI-së, kjo i pamundëson qytetarëve të prekur nga ky vendim që të marrin shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet vendimtare, bazën ligjore dhe arsyet pse ky vendim është i zbatueshëm në rastin konkret. "Pas publikimit të vendimit, kryetari i Komunës së Prishtinës më 23 gusht

2023 në rrjetin e tij social 'Facebook' ka publikuar një status përmes të cilit ka sqaruar vendimin e nxjerrë. Me këtë rast, IKD i rikujton kryetarit të Komunës së Prishtinës se sipas ligjit arsyetimi e ka vendin në vendimin e nxjerrë dhe jo në rrjetet sociale.

Në anën tjetër, udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna ka përcaktuar rregullat dhe procedurat që duhet të ndjekin komunat për zhvillimin e konsultimeve publike. Konsultimet publike duhet të jenë reale, në atë mënyrë që të marrin parasysh kërkesat e qytetarëve dhe ti përshtatin

ato me reformat që synohet të ndërmerren. Procesi i konsultimeve publike nuk kërkon vetëm zhvillimin formal të këtij procesi. Kështu, në rastet kur merren vendime të kësaj natyre, Komuna e Prishtinës duhet të zhvillojë konsultime publike kualitative, në atë mënyrë që vendimi të merr parasysh interesat e qytetarëve dhe mos të cenoj të drejtat e tyre", thuhet në reagim.

Për këtë arsye, IKD-ja i rekomandon Komunës së Prishtinës që të anulohë vendimin e datës 18 gusht dhe para nxjerrjes së vendimit të ri lidhur me këto rrugë, të zhvillojë konsultime publike cilësore si dhe të nxjerrë vendim të arsyetuar, ashtu siç kërkohet me ligj.

Hovenier njofton për angazhimin e këshilltares për çështje publike

PRISHTINË, 28 GUSHT - Ambasadori amerikan, Jeff Hovenier ka njoftuar se ka mirëpritur Jennifer Lawson, këshilltaren për çështje publike. Ai ka njoftuar se Lawson do të merret me iniciativat e

diplomacisë publike. "Ju lutemi bashkohuni me mua për të mirëpritur në Kosovë Këshilltaren për Çështje Publike Jennifer Lawson! Pres me padurim udhëheqjen e Jennifer-it të iniciativave tona të

diplomacisë publike. Unë jam i sigurt se do ta shihni atë jashtë dhe aty tek ekipi ynë vazhdon të thellojë partneritetin tonë të fortë me popullin kosovar", ka shkruar Hovenier në rrjetet sociale.



Protestojnë punëtorët e sigurimit fizik të KEK-ut, hedhin vezë para zyrave të korporatës në kryeqytet

PRISHTINË, 28 GUSHT - Punëtorët e sigurimit fizik në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) kanë protestuar të hënën para

objektit të KEK-ut dhe të Qeverisë së Kosovës. Ata kanë kërkuar rikthimin si punëtorë të KEK-ut dhe jo të tenderohen

vazhdimisht në sektorin privat. Si shenjë pakënaqësie ata hodhën edhe vezë para zyrave të KEK-ut në kryeqytet.



Paratë e diasporës, “infuzion” për ekonominë



PRISHTINË, 28 GUSHT - “Realisht, varemi shumë nga diaspora. Të gjitha bizneset i presin këta muajt”, thotë Kujtim Behluli, përfaqësues i një qendre tregtare në Suharekë. Gjatë muajve të verës, thotë ai, shitjet rriten për më shumë se 50 për qind. Në veçanti nga data 20 korrik deri më 15 gusht, shitjet dallojnë shumë nga muajt e tjerë të vitit, thotë Behluli. Vizitat e qytetarëve të Kosovës që jetojnë në vende të ndryshme të botës janë më të shumta gjatë verës. Vetëm në korrik, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” janë regjistruar 400 mijë hyrje-dalje. Flukse të mëdha njerëzish ka pasur edhe në kufijtë tokësorë. Zvicra, Gjermania dhe Austria janë

destinacionet me më së shumti udhëtarë dhe fluturime. Këto janë edhe tri shtetet ku diaspora e Kosovës është e përqendruar më së shumti.

Diaspora ringjall hotelerinë e turizmin

Hysen Sogojeva, udhëheqës i Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, thotë për Radion Evropa e Lirë se këtë sektor e ringjall “fluksi i madh i mërgimtarëve”. “Mjetet që ata i shpenzojnë në Kosovë, janë infuzion për ekonominë, e më së shumti për hotelerinë dhe gastronominë”, thotë Sogojeva për Radion Evropa e Lirë. Nga vizitat në biznese të ndryshme, ai thotë se pothuajse secili prej tyre ka

raportuar rritje të numrit të vizitorëve për më shumë se 25 për qind. “Mezi ka mbijetuar ky sektor, por tani fluksi i diasporës ka bërë që këto biznese ta rimarrin veten”, thotë Sogojeva, duke iu referuar periudhës së pandemisë Covid-19.

BQK-ja: Të hyrat nga diaspora, faktor i rëndësishëm për ekonominë

Nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) thonë për Radion Evropa e Lirë se diaspora e Kosovës ka një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë e vendit përmes dërgimit të remitencave, investimeve në patundshmëri

dhe shpenzimeve që bëjnë gjatë pushimeve në Kosovë. Në vitin 2022, vlera e remitencave apo e parave të dërguara nga diaspora në Kosovë ka arritur në 1.22 miliard euro, që do të thotë 6.0 për qind më shumë se vitin paraprak, ndërsa vlera e shpenzimeve që diaspora ka bërë në Kosovë ka qenë afro 2 miliardë euro. “Gjatë vitit 2022, remitencat kanë përbërë rreth 13.7% të Bruto Produktit Vendor (BPV), shërbimet e udhëtimit rreth 20.9 % dhe investimet e huaja direktete në patundshmëri rreth 5.3 %. Në total, ato përbëjnë rreth 40% të BPV-së”, thuhet në deklaratën e BQK-së, dërguar Radios Evropa e Lirë. Sipas saj, në gjashtëmujorin e parë të këtij viti vlera e

remitencave ka qenë 632.9 milionë euro, ndërsa vlera e shpenzimeve të diasporës, në pesë muajt e parë të vitit, ka qenë mbi 593 milionë euro.

Bazuar në këto të dhëna, sipas BQK-së, të hyrat nga diaspora janë një faktor i rëndësishëm për rritjen ekonomike, e cila vitin e kaluar ka arritur në 3 për qind.

Ngjashëm pohon edhe eksperti i çështjeve ekonomike, Haki Shatri, njëherësh ish-ministër i Ekonomisë dhe Financave. Përveçse i kontribuojnë rritjes ekonomike, thotë ai, mjetet e diasporës shërbejnë si të ardhura shtesë për njerëzit në nevojë.

“...dhe jo të gjitha këto mjete evidentohen, disa hyjnë edhe në mënyra që nuk arrijnë të regjistrohen”, thotë Shatri.

“Dërgoj para çdo muaj”

Në muajin korrik, REL-i bisedoi me disa qytetarë nga diaspora, që vizituan ambientet e Kuvendit të Kosovës, gjatë aktivitetit tradicional “Bashkatdhetarët në Kuvend”.

Pothuajse të gjithë nga ta thanë se dërgojnë para çdo muaj për familjet e tyre në Kosovë. “Kam motrat këtu dhe nënën dhe më duhet t'i ndihmoj. Dërgoj para çdo muaj. Edhe për mua është vështirë t'i ndaj ato mjete që i dërgoj në Kosovë, por punojmë shumë dhe ia dalim”, tha Hysni Makovci, i cili jeton në Gjermani nga viti 1999. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit, deri në fund të vitit 2018, ka qenë mbi 850.000.

Asetet e Fondeve Pensionale kapin vlerën e 2.6 miliardë eurove

PRISHTINË, 28 GUSHT - Asetet e Fondeve Pensionale në Kosovë kanë arritur vlerën e 2.6 miliardë eurove. Sipas statistikave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për muajin korrik, kjo shifër përfaqëson rritje prej 66.4 milionë euro krahasuar me muajin

qershor. “Struktura e aseteve të sektorit pensional dominohet nga letrat me vlerë të kapitalit që përbejnë 76.4% të gjithë aseteve. Vlera e tyre në korrik 2023 ka arritur në 1.99 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 225.4 milionë euro krahasuar me

muajin paraprak. Kjo rritje kryesisht i atribuohet rritjes së investimeve jashtë vendit, por njëkohësisht është vërejtur se ka pasur rritje të performancës së letrave me vlerë ekzistuese të cilat janë investuara me herët”, ka njoftuar BQK-ja.



Historia e një filmi të pavdekshëm dhe dy dashnorëve, vdekatarë por të paharrueshëm

Një thënie fanceze thotë se gjithçka kalon, gjithçka ndryshon, gjithçka harrohet, gjithçka zëvendësohet... Por nuk është e sigurt

“Nëse ju keni nevojë për një aktore suedeze që flet shumë mirë anglisht, që nuk e ka harruar gjermanishten e saj, që nuk kuptohet shumë mirë në frëngjisht dhe që në italisht di vetëm të dua, jam gati të bëj një film me ju”.

Firmosur: Ingrid Bergman.....

Roberto Rossellini përfundoi së lexuari letrën e datës 1950 dhe mbeti i mahnitur. Ishte 44 vjeç, i martuar me italianen Marcella de Marchis me të cilën kishte 2 fëmijë, ishte dashnor i asaj force natyrore të quajtur Ana Magnani dhe që

ende nën regjimin fashist dhe është ngjarja reale e një prifti, Luigi Morosini-it i torturuar dhe vdekur gjatë pushtimit nazist për të mbrojtur partizanët dhe inxhinierit komunist, Giorgio Manfredi. Pika kulmore dhe skena e



nuk ishte e vetmja e koleksionit të tij. Por bukuria e Bergmanit dhe përkufizimi i Federiko Felinit (është sikur Shën Mëria të ketë zbritur në Disneyland) ishin tundime të mëdha.

Nga ana tjetër Rossellini ishte një nga etërit e mrekullisë që u quajt neorealizmi italian; kinemaja pas luftime, kundërpeshë e fashizmit mbytës, art i varfër në një vend të shkatërruar dhe regjisori... kronologjikisht i konsideruar një film i jashtëzakonshëm i asaj rryme: “Roma, qyteti i hapur” i vitit 1945.

Një histori sa e vërtetë aq edhe e trishtë. Ngjarjet vendosen në Romë nga viti 1943 dhe 1944,

përrjetshme e ngulitur në kujtesë si shkalla e Odesës tek filmi “Potemkini i blinduar”: Pina, një fshatare dhe e dashura e një tipografi, i cili lufton me Rezistencën dhe që



burgoset, vrapon e dëshpëruar pas kamionit, por një plumb mitralozi e godet dhe ajo vdes para djalit të saj. Ato çaste kinemaje, ajo grua e papërsëritshme (Ana Magnani), ajo rrugë me të vetmin fat – vdekjen, dhe vetmia e atij fëmije, janë momente të paharrueshme dhe që përbëjnë gjenialitetin e kinemasë italiane, e cila u shtri që nga këta filma origjinalë, kurajozë, ideologjikë plot me mesazhe dhe me fitime të pakta deri në vdekjen e Federiko Felinit, Ettore Scola-s, Mario Monicelli-it. Kinema që nuk u harrua dhe një jehonë e denjë e filmit “Cinema Paradiso” e Giuseppe Tornatore-s. “Roma, citta aperta” lindi pa para, vetëm me dy aktorë profesionistë (Aldo Fabrizi dhe Magnani) dhe mes katër skenaristëve, ku u shkicua një e ardhme e përgjakur, ishte ai, Federiko Felini që i përket mbinjeriut.

Kthehemi tek dashnorët tanë...

Borgjezi, jo shumë i pashëm dhe heroina e Kazablankës ranë në rrjetën e dashurisë ose më mirë e thurën atë. Piknik për paparacët, shtypi, anatemimi i hipokratizisë

amerikane. Besojeni ose jo, në 14 mars të 1950 Dhoma e Lartë e Kongresit Amerikan nga goja e senatorit demokrat, Edwin Johnson kërkoi masa ligjore që të ndalonin daljen e filmit “Stromboli”, sepse në jetën reale protagonistja ndërmori një sulm kundër institucionit të martesës. Zonja Bergman është një ndikim i keq për virtytet morale amerikane. Nëse kishte një botë ku tradhtia, orgjitë, dashuritë klandestine, divorcet, alkooli dhe drogat përcaktonin fabrikën kolosale ai ishte Hollywood-i.

Rossellini dhe Ingrid edhe pse shkelëskurore; ajo ishte e martuar me dentistin suedez Petter Lindström me të cilin kishte një vajzë, Pia, por ishin ...europianë. Ata u martuan, patën tre fëmijë: Robertinon dhe binjaket Issota dhe Isabella dhe gjithçka përfundoi alla italiane. Gjatë një fundjave romantike në Amalfi ajo i përgatiti spageti me salcë domatesh dhe djathë parmexhan të grirë dhe ia hodhi mbi kokën e këtij burri, këtij borgjezi roman, gjeniu që realizoi 40 filma dhe 20 seri në televizion, derisa kanceri e mori nga kjo botë në moshën 71 vjeçare. Fundi i romancës... Ingrid Bergman vdiq shumë e re, në moshën 67 vjeçare.

Një dekadë më vonë Kongresi Amerikan nga goja e senatorit Charles Percy lexoi një fjalim shfajësimi: “Sot dua të bëj një homazh që prej kohësh ia kemi borxh Ingrid Bergmanit, një ylli të vërtetë në kuptimin e plotë të fjalës. Zonja Bergman jo vetëm që është e mirëpritur në Amerikë, por jemi thellësisht të nderuar nga vizita e saj!” Ajo u përgjigj: “I dashur Senator Percy, lufta ime me Amerikën ka mbaruar prej kohësh. Megjithatë plagët mbeten. Sot falë gjestit shumë të sjellshëm dhe bujar të fjalimit tuaj në Senat janë shëruar përgjithmonë”. Gjithçka mbeti mbrapa. Dashnorët e ndaluar kishin vdekur...

Skandalet seksuale të Hollywood-it janë shtuar dhe vazhdojnë të shtohen pa frena dhe pa dënime, por në errësirën e një salle kinemaje, ose në shtëpi, ose në internet ose në CD, “Roma qyteti i hapur” vazhdon e mbetet e gjallë, e përvuajtur me Magnanin e vdekur nga një plumb mitralozi dhe me fëmijën duke e parë me sy të tmerruar... Një thënie fanceze thotë se gjithçka kalon, gjithçka ndryshon, gjithçka harrohet, gjithçka zëvendësohet... Por nuk është e sigurt. / scoopnest.com – bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Dushku e përfaqësoi FBK-në në Kongresin e FIBA-s në Manila

PRISHTINË, 28 GUSHT - Sekretarja e Përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Elvira Dushku e ka përfaqësuar FBK-në në Kongresin e FIBA-s, që është mbajtur në Manila më 23 e 24 gusht, ku është zgjedhur Presidenti dhe Bordi Qendror i ri i FIBA-s. Krahas Kongresit, Dushku ka marrë pjesë edhe në hapjen solemne të

FIBA Kampionatit Botëror, që është organizuar më 25 gusht në Manila me një atmosferë të paharruar. Gjithashtu Dushku ka pasur rastin të shikoj nga afër dy ndeshje të Botërorit, Angola - Italia dhe Republika Dominikane - Filipine. Në këtë të fundit është thyer rekordi i shikueshmërisë në një Botëror të basketbollit me

38,115 shikues të pranishëm në palestrën që zë 50,000 shikues, "Philippine Arena". Dushku ishte edhe pjesë e Punëtorive të organizuara nga FIBA në kuadër të Kongresit me temat: Vajzat dhe Gratë në Basketboll, Integriteti në Basketboll dhe Përgatitja e Planeve Strategjike për Federatat Nacionale.



Ilir Blakçori, 'Ylli i javës' në Superligë

PRISHTINË, 28 GUSHT - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall vazhdojnë me ndarjen e çmimit "Ylli i javës". Për xhiron e 3-të të Albi Mall Superligës ky çmim i takon mbrojtësit të majtë të KF Llapi, Ilir Blakçori. Komisioni i veteranëve të futbollit vendosi që epiteti i më të mirit për këtë xhiro t'i takojë mbrojtësit të skuadrës llapjane, pasi në ndeshjen kundër Fushë Kosovës përveç se ishte stabil në mbrojtje ishte shumë i dobishëm edhe në fazën

ofensive, duke shënuar një gol, që ia mundësoi KF Llapi t'i gëzohet fitores dhe të arkëtojë 3 pikët e radhës në Albi Mall Superligë. Çmimin "Ylli i Javës" për futbollistin e KF Llapit, Ilir Blakçori e ndau Melisa Uka, specialiste e marketingut në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim, Blakçori u shpreh i lumtur që skuadra e tij shënoi fitoren e radhës në elitën e futbollit në Kosovë. "Është kënaqësi të shpallesh më i miri i xhiros. Për mua ky është çmimi i parë dhe ndihem tejet i vlerësuar. Kjo do



të ishte e pamundur pa ndihmën e bashkëlojtarëve dhe shtabin teknik, andaj shfrytëzoi rastin t'i falënderoj për bashkëpunimin. Këtë edicion e kemi nisur mbarë ndonëse kemi ndërtuar një ekip pothuajse të ri. Na duhet akoma kohë që të komponohemi për të paraqitur në fushën e gjelbër më të mirën tonë. Atmosfera në ekip është e mirë dhe besoj që performanca jonë do të na dërgojë sa më lart në renditje", ka thënë Ilir Blakçori për faqen zyrtare të FFK-së.

Kuka: Sporti serioz rrit imazhin e shtetit, jo garat 'show'



Prishtinë, 28 gusht - Trajneri i xhudos Driton Kuka ka bërë thirrje që t'iu jepet më shumë vëmendje sukseseve të mëdha të sportistëve të Kosovës nëpër botë, e jo sporteve që ofrojnë vetëm "show". Kuka ka shkruar në "Facebook" për suksesin e pak javë më parë të xhudistes Laura Fazliu në Mastersin e Budapestit. Kuka ndër të tjera ka thënë se "trumbetimi i sukseseve pa asnjë vlerë po ngreh kokën prapë në Kosovë e në fakt Olimpiada po vjen e Normat Olimpikë s'po shihen në sfond". "Për një javë të mbarë... Gëzimi i medaljes së artë në finalen e Masters javë më parë në Budapest Hungari!

Protagoniste një sportiste që u ngjit në kulmin Botëror, Laura Fazliu pas kësaj gare kryeson Ranglistën Olimpikë kategoria 63 kg. Përderisa Laura dha shumë intervista për media të fuqishme Botërore, në Kosovë mediet si duket ishin në pushime verore me përjashtime kuptohet! Trumbetimi i sukseseve pa asnjë vlerë po ngreh kokën prapë në Kosovë e në fakt Olimpiada po vjen e Normat Olimpikë s'po shihen në sfond. Sporti serioz rrit imazhin e shtetit e jo garat 'show' e mashtrimet që s'po na ndahen në Kosovën tonë tash e 24 vjet pas çlirimit!", ka shkruar Kuka.

Gashi zë vendin e pestë në Kampionatin Evropian

TALIN, 28 GUSHT - Taekwondisti, Jon Gashi, zuri vendin e 5-të në Kampionatin

Evropian për junior, të mbajtur në Talin të Estonisë, shkruan Komiteti Olimpik i

Kosovës. Gashi (-73 kg), bursist i KOK-ut si shpresë olimpikë 2023, arriti deri në

çerekfinale, pas fitores në raundin e dytë, derisa të parën e kaloi pa luftë.



Usyk: Dubois luajti pistë në ring, jam gati t'i jap revanshin në një duel rruge

SIMFEROPOL, 28 GUSHT - Oleksandr Usyk mbrojti titujt kampion bote në peshën e rëndë pas fitores me KO në raundin e nëntë ndaj britanikut Daniel Dubois. Një duel që shkaktoi mjaft polemika për një goditje nën

brez që britaniku i dha kampionit ukrainas në raundin e pestë, që sollën ndërprerjen e duelit për disa minuta. Mjaft e konsideruan këtë goditje si të rregullt, duke bërë që polemikat të vijojnë ende edhe pas 48 orësh nga sfida. Vetë

Usyk reagoi duke thënë: "Ishte një goditje e ulët e Daniel, që dueliu pisët në ring. Nuk është ky boksi që dëshirojmë. Gjithsesi, ia tregova vendin që meritonte". Më tej, kampioni i botës thumbon Dubois: "Jam gati për revanshin ndaj tij, që

nesër, në një luftë rruge. Jam gati. Jo doreza boksi, por një duel boksi në rrugë dhe aty do ta shohë se kush jam. Aty le të provojë të godasë nën brez". Usyk mbeti i pamposhtur pas kësaj sfide (21 fitore, 0 humbje).



Ramadani: Te Lecce kam ardhur për të lënë gjurmë

LECCE, 28 GUSHT - Ylber Ramadani ka zhvilluar një tjetër ndeshje fantastike në Serie A, teksa me Leccen e tij barazuan 2-2 ndaj Fiorentinës. Mesfushori shqiptar ka qenë ndër më të mirët në fushë dhe arriti të fitonte shumë duela me Giacomo Bonaventurën dhe mesfushorin brazilian Arthur. Pas përfundimit të ndeshjes ferizajasi ka folur për mediet italiane duke treguar si po ecën karriera në Serie A dhe u ndal për të folur edhe për paraardhësin e tij në mesfushën e Lecces, Hjulmand. "Nuk e nisëm mirë pjesën e parë, duke pësuar një gol, por më pas reflektuam për gabimet tona dhe u përmirësuar. Më duhej të ruaja Arthurin dhe u mundova pak, por më pas dola kundër Bonaventuras dhe ishte më mirë", ka thënë Ramadani. "Çfarë do të thotë të zëvendësoh Hjulmand? Në futboll duhet të marrësh përgjegjësi çdo ditë, por unë



erdha këtu për të lënë gjurmën time. Hjulmand ishte i rëndësishëm vitin e kaluar, por kjo është e kaluara, unë duhet të bëj më mirë që Lecce të qëndrojë në Serie A", ka shtuar Ramadani. Ai thotë se më parë është trajnuar nga një trajner

italian dhe tanimë e di mentalitetin që duhet të jetë në Serie A. "Në Serie A ka një nivel tjetër në krahasim me Skocinë, por më ka trajnuar një italian dhe tashmë e di se çfarë mentaliteti ka këtu", u shpreh mesfushori shqiptar.

Klopp për përmbysjen ndaj Newcastle: Fitorja më e bukur e karrierës

LIVERPOOL, 28 GUSHT - Liverpooli arriti një fitore të madhe ndaj Newcastle United në "St. James me Park" me rezultat 1-2. Liverpooli në minutën e 25-të pësoi gol dhe tre minuta me pas mbeti me dhjetë lojtarë, pasi Van Dijk u ndëshkua me karton të kuq. "The Reds" e përmbysën rezultatit me dy golat e zëvendësuesit Darëin Nunez (81' dhe 93'). Trajneri Jurgen Klopp ka thënë se kjo përmbysje më e bukur se ajo ndaj Barcelonës. "Kjo përmbysje ishte edhe më e vështirë e më e bukur se ajo ndaj Barcelonës në Ligën e Kampioneve. Nuk kam përjetuar një ndjesi të tillë në 1000 ndeshjet e mia si trajner. Është diçka për t'ia treguar brezave të ardhshëm. E vetmja mundësi për të fituar ishte të mos pësonim një gol të dytë dhe që Trent të mos ndëshkohej me një tjetër karton të verdhë. Në fund ia



dolëm dhe jam shumë i gëzuar. Për mua Van Dijk nuk duhej të ndëshkohej me karton të kuq. Nëse do të shihja diçka të tillë

në stërvitje nuk do ta ndalja lojën, por kjo është arsyeja pse unë nuk jam gjyqtarë", ka thënë Klopp.

SHKURT

Berisha, afër zyrtarizimit te Empoli

Etrit Berisha pritet që t'i bashkohet Empolit. Klubi italian po kërkon të nënshkruajë me portierin shqiptar pas lëndimit të Elia Caprile, i cili do të mungojë për së paku dy muaj. Sipas "TMW", Berisha tashmë ka marrëveshje me Empolin dhe së shpejti pritet të zyrtarizohet. 34-vjeçari do të nënshkruajë kontratë njëvjeçare, me opsion për zgjatje të bashkëpunimit edhe për një vit të dytë. Reprerentuesi i Shqipërisë është pjesë e Torinos dhe ka kontratë të vlefshme deri në verën e vitit të ardhshëm. Megjithatë, mungesa e madhe e minutave besohet se po e shtyn drejt largimit. Empoli do të jetë klubi i pestë italian në karrierën e Etrit e Berishës.

Behrami: Interi pa Lukakun shkoj në finalen e Ligës së Kampioneve

Ish-mesfushori i Kombëtares së Zvicrës, Valon Behrami ka folur së fundmi për sulmuesin Romelu Lukakun, i cili pritet të firmosë me Romën në orët në vijim. Sipas Behramit, Lukaku nuk bën ndryshim të madh në lojën e një skuadre. "Lukaku nuk është një lojtar që i ndryshon shumë ekuilibrat. Edhe vitin e kaluar te Interi nuk ishte ai që tërhoqi ekipin, të gjithë ishin mirë dhe arritën në finalen e Ligës së Kampioneve pa Lukakun. Kishte ndeshje në të cilat belgu e kishte idenë e golit", ka deklaruar Behrami.

Mançini, trajner i ri i Arabisë Saudite

Trajneri Roberto Mançini është zyrtarisht trajneri i kombëtares të Arabisë Saudite. Këtë lajm e ka bërë publik institucioni më i lartë i futbollit në Arabinë Saudite përmes rrjeteve sociale ku kanë publikuar një video të teknikut italian. "Kam bërë histori në Evropë, tani është koha për të bërë histori në Arabinë Saudite", me këto fjalë trajneri Roberto Mançini zyrtarizon pozicionin e tij të ri, atë të trajnerit të kombëtares së Arabisë Saudite.

Neueri rikthehet në stërvitje

Bayern Munchen mori lajm të mirë, pasi kapiteni dhe lideri i skuadrës Manuel Neuer është rikthyer në stërvitje. Portieri gjerman ka përfunduar stërvitjen e parë që prej dhjetorit të kaluar kur e theu këmbën duke bërë ski. Lajme inkurajuese edhe për Jamal Musiala. Mesfushori-sulmues ka përfunduar një seancë vrapimi në fushën stërvitore. Për momentin po punon veçmas grupit vetëm Raphael Guerreiro.

PSG-ja bën ofertë të re për Kolo Muanin

Paris Saint-Germaini ka bërë një ofertë të re për Randal Kolo Muanin ku vlera është 70 milionë euro plus tjera si bonuse. Nëse drejtori sportiv i Eintracht Frankfurtit, Markus Krosche, i thotë po ofertës, atëherë një marrëveshje do të mund të mbyllet brenda 48 orëve. Më parë është raportuar se vlerësimi i klubit gjerman për Kolo Muanin është afër 100 milionë euro. 24-vjeçari tashmë ka rënë dakord për kushtet personale me PSG-në, teksa po pret që të arrihet një marrëveshje mes klubeve.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë Shpall Konkurs publik për këtë vende punës :

KONKURS

Pozita : PUNËTORI FIZIKË- / NË MBLEDHJEN E HEDHURINAVE 4 Punëtor Fizik.

Vendi i punës Istog (1 pozita)

Vendi i punës Klinë (3 pozita)

Kontrat punës me kohë të caktuar me mundësi vazhdimi , periudha provues 6 muaj.

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

- 1.Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e hedhurinave.
- 2.Mbledh hedhurinat dhe bënë zbrazen e Kontenjerve dhe mjeteve tjera për hedhurina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- 3.Pas zbrazjes së Kontenjerve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdesë.
- 4.Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
5. Kryen edhe punë tjera me urdhëres Shoferit, Kryepunëtorit
6. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Shoferit, Kryepunëtorit, Menaxherit të Operatives, Kyeshefit Ekzekutiv

Kushtet:

- Shkollimi fillore
- Aftesi fizike dhe psikike te deshmuar
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Pozita : **ARKATARI / E**

Kontrat punës me kohë të caktuar me mundësi vazhdimi , periudha provues 6 muaj.

Ka këto detyra dhe përgjegjësi

- 1.Pranon pagesat në të gatshme dhe plotëson fletëpagesën në tri kopje, kopjen e pare ia dorëzon pales.
- 2.Furnizon –tërhekë dhe jep triskat për lëndë djegëse dhe evidencën e tyre.
- 3.Udhëheqë ditarin e arkës veçmas për karburante.
- 4.Të hyrat e gatshme i dorëzon në bankë-xhiro llogarin e Ndërmarrjes, pa vonesë.
- 5.Përpilon ditarin e arkës për çdo ditë mbi të hyrat dhe të dalurat dhe ia
- 6.bashkangjet dokumentacionin në gjendje të rregullit, i verifikuar nga personat e autorizuar.
- 7.Mban përgjegjësi për pagesën e dokumenteve të cilat nuk janë të vërtetuara nga personat e autorizuar, që janë në kundërshtim me ligjin.
- 8.Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Përgjegjësit financiar, Kryeshefit Ekzekutiv
- 9.Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv

Kushtet:

- Shkolla e mesme ekonomike, përparesi Diplome Universitare
- 1 vite përvojë pune.
- njohja e punës me kompjuter.
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë;

Mënyra e Aplikimit: Dokumentat dorëzohet në ndërtesën e Ndërmarrjes "Ambienti" S.H.A Rr Xhem Sadrija pn në Pejë. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur në të cilin duhet të shkruhet pozita për të cilën aplikon. Data e fundit për aplikim është më: 13.09.2023 ora 16:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në kopje pasi të njëjtat nuk ju kthehen. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

Njoftim për mbrojtjen publike të punimit të doktoratës

Njoftojmë të interesuarit se me datën 06.09.2023 (e mërkurë), në orën 11:00, në sallën e Profesorëve të Fakultetit Ekonomik, kandidati Sead Ujkani do ta bëjë mbrojtjen publike të punimit të doktoratës me titull: "Efekti i kontrollit të brendshëm në arritjen e objektivave të organizatave buxhetore".

Ftohen të interesuarit që të marrin pjesë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- D.P.H. Bonita-M, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 70979349.

- Granit Rrustemaj shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjmnazit "Xhevdet Doda" Prishtinë.

- Ersen Sabri Hoxhaxhiku shpall të pavlefshme dëftesat di dhe diplomën e Gjmnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- Blerta Bala nga Gjakova shpall të pavlefshme Diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Ismet Tahiraj, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani", ish-shkollës "Brois Kidriç".

- N.P.SH BEST WEY, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NRB 811333880, "Bekim Shkreli B.I".

- N.P.SH BEST WEY, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me NR: 330433954, "Bekim Shkreli B.I".

- Driton Hajrizi, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Arkitekt Sinani".

- Albina Bucolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-9 të shkollës "Fazli Grajqevci" Poglek Vasilev komuna e Drenasit.

- Alban Bucolli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. 1-9 të shkollës "Fazli Grajqevci" Poglek Vasilev komuna e Drenasit.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
LOCAL PUBLIC ENTERPRISE
NPL "KUZHINA QENDRORE" SH.A.
PRISHTINË
Nr. 0297 dt. 29.08. 2023

Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinagendrore@gmail.com | tel: + 383 45 709 106

Konform me funksionet dhe kompetencat që parashihen me nenin 21, lidhur me nenin 17, dhe 25 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Ligji nr.03/L-087, dt.13.06.2008, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dt. 20.04.2012; me tej në tekst: Ligji nr.03/L-087) Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 28.08.2023 ka marrë vendim për të shpallur:

KONKURS PËR VEND TË PUNËS

TITULLI I PUNËS: 1. ZYRTAR KRYESOR FINANCIAR DHE I THESARIT (1 VEND PUNE)

Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të financave në N.P.L Kuzhina Qendrore Sh.A.

Zyrtar Kryesor Financiar dhe i Thesarit duhet t'i plotësojë kushtet e kualifikimit dhe të pavarësisë sipas nenit 21, lidhur me nenin 17, të ligjit 03/L-087, i ndryshuar e plotësuar më vonë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhon, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv çështjet financiare të ndërmarrjes.
 - Mirëmban llogaritë bankare të Ndërmarrjes të azhuruara dhe të sakta.
 - Themelon dhe udhëheq të gjitha kontrollat e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimin e parave të gatshme, monitoron llogaritë e pagueshme, bënë pagesat e faturave dhe blerjet speciale.
 - Menaxhon thesarin e Ndërmarrjes.
 - Përgatitë të dhënat e Ndërmarrjes për auditim në fund të çdo viti.
 - Përgatitë buxhetin dhe kryen detyra tjera nga fusha e financave të përcaktuara nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.
 - ZKFTH i raporton Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve;
- Kushtet për Aplikim të Kandidatit
- Diplomë universitare në Fakultetin Ekonomik ose të ngjashme;
 - Të posedoj përvojë profesionale së paku pesë (5) vite në nivel të lartë menaxherial nga fusha e financave dhe kontabilitetit;
 - Posedimi i certifikimit në kontabilitet është përparësi;
 - Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe 17.2 dhe 17.3 të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe plotësim ndryshimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 04/L-111 neni 13;
 - Të ketë shkathtësi kompjuterike posaçërisht mbi sistemet e avancuara në fushën e financave/kontabilitetit;
 - Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
 - Të ketë aftësi në të shkruar dhe komunikim;
 - Preferohet njohja e gjuhës angleze;
 - Aftësi organizative, koordinuese dhe nder personale;

Performanca e zyrtarit do të vlerësohet nga Bordi i Drejtorëve në mënyrë vazhdueshme.

TITULLI I PUNËS: KËSHILLTAR I PËRGJITHSHËM/SEKRETARI I KORPORATËS (1 VEND PUNE)

Këshilltari i Përgjithshëm është zyrtar i kompanisë, bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087) dhe është përgjegjës për përfaqësimin dhe mbrojtjen ligjore të Kompanisë. Këshilltar i përgjithshëm/Sekretari i Korporatës duhet t'i plotësojë kushtet e kualifikimit dhe të pavarësisë sipas nenit 21, lidhur me nenin 17, të ligjit 03/L-087, i ndryshuar e plotësuar me vonë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është person përgjegjës për pranimin e dokumentacionit të Ndërmarrjes.
 - Kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe së bashku me Kryeshefin Ekzekutiv bënë përgatitjen e dokumenteve të Ndërmarrjes.
 - Menaxhon me dokumentacionin zyrtar, kontratat e punëtorëve, përshkrimin e vendeve të punës si dhe përfaqëson juridikisht Ndërmarrjen në kontestet gjyqësore.
 - Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit.
 - Mban regjistrin e aksionarëve.
 - Kryen detyra tjera të përcaktuara nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.
- Kushtet për Aplikim të Kandidatit
- Kandidati duhet të ketë diplomë nga Fakulteti Juridik (Jurist i diplomuar ose Master në shkencë Juridike);
- Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë punë profesionale, në nivel të lartë menaxherial;
 - Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe sipas nenit 17.2 dhe 17.3 të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
 - Të posedoj njohuri të punës me kompjuter;
 - Të ketë integritet të lartë moral e profesional;
 - Të ketë aftësi në të shkruar dhe komunikim;

- Të ketë përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Performanca e zyrtarit do të vlerësohet nga Bordi i Drejtorëve në mënyrë vazhdueshme.

TITULLI I PUNËS: ZYRTARI AUDITIMIT TË BRENDSHËM (1 VEND PUNE)

Detyrat dhe Përgjegjësitë

- Udhëheq, menaxhon dhe bënë organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit, duke mbikëqyrë stafin e zyrës.
- Udhëheq dhe drejton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe për këtë raporton te Komisioni i Auditimit.
- Kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara nga ana e Komisionit të Auditimit, Kryeshefit Ekzekutiv dhe Bordit të Drejtorëve.

Kushtet për Aplikim të Kandidatit

- Të ketë diplomë universitare në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet;
- të jetë Auditor i Brendshëm i Certifikuar;
- Kandidati duhet të ketë së paku 5 vite përvojë punë profesionale, në nivel të lartë menaxherial;
- Të plotësoj kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1. si dhe sipas nenit 17.2 dhe 17.3 të ligjit nr. 03/L-087 të ndërmarrjeve publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13;
- Të posedoj njohuri të punës me kompjuter;
- Të ketë aftësi për të interpretuar dhe zbatuar Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar;
- Të posedojë aftësi për kryerjen e një game të gjerë të aktiviteteve, përfshirë këtu vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm, analizën e informacioneve financiare dhe jo-financiare, kontrollimin e aktiviteteve operationale, zbulimin e gabimeve të mundshme brenda entitetit dhe gjithashtu ofrimin e sugjerimeve të nevojshme për përmirësim;
- Të ketë pavarësi dhe nivel të lartë të integritetit për gjatë aktiviteteve në korporatë;
- Të ketë integritet profesional për të kryer një vlerësim të pavarur të efikasitetit të politikave, procedurave dhe standardeve përmes të cilave bëhet menaxhimi i resurseve financiare, fizike dhe informative;
- Të ketë aftësi në të shkruar dhe komunikim;

Paga dhe kushtet e tjera për këto vende pune, do të përcaktohen në bazë të Nenit 22 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike në Republikën e Kosovës.

Aplikacionet duhet të dërgohen të shkruara në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.

Forma e Aplikacionit si dhe Deklaratës nën Betim mund të merren në www.kuzhina.net

Dokumentacioni i kërkuar

- Aplikacionin për punësim, i cili mund të merret në faqen e N.P.L Kuzhina Qendrore;
 - CV e detajuar e kandidatit;
 - Letër motivuese;
 - Dëshmitë e shkollimit dhe kualifikimet e kërkuara (diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHTI-t);
 - Dëshmitë e përvojës së punës dhe pasqyra e trustit pensional;
 - Referencat dhe certifikatat tjera profesionale;
 - Deklaratën nën Betim e cila merret në faqen e N.P.L Kuzhina Qendrore Sh.A ;
 - Certifikatën nga gjykata kompetente që kandidati nuk është nën hetime jo më vjetër se 6 muaj;
 - Kopjen e letërnjoftimit;
- Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në këtë adresë:
Zyrtar Qendrore të N.P.L. "Kuzhina Qendrore" sh.a, rr. "Egnatia", p.n. Ulpiane, 10000, Prishtinë, Kosovë.
- Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën.
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.
- Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
- Konkursi është i hapur nga data: 29 gusht 2023 deri me 28 shtator 2023 ora 16:00**
- Për çfarëdo informate shtese ju lutem na kontaktoni në:
Email: kuzhinagendrore@gmail.com
tel: 045 709 106

